



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 487/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 03 / 2019

V E N D I M

Nr. 45, Datë 27 / 03 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 167, datë 23.10.2018, të bërë nga E.Ç, kundër Bashkisë Korçë me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës¹”, “gjendjes ekonomike² dhe civile”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se është nëna e 3 vajzave të mitura³ të cilat kanë lindur nga bashkëjetesa me të ndjerin E.F i cili u nda nga jeta në mjediset e parburgimit të Komisarariatit të Policisë në Korçë në datë 17.05.2018. Ankuesja shprehet se që nga dita e ngjarjes, asaj dhe fëmijëve të saj pavarësisht se i është premtuar ndihmë nga ana sociale dhe psikologjike, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Korçë nuk i është ofruar asnjë ndihmë. Nga ana e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve nuk është ofruar asnjë ndihmë në paketa ushqimore apo ilaçe. Ankuesja shprehet se i është ofruar një shtëpi e cila është në gjendje të mjerueshme dhe i është drejtuar Drejtorisë së Përkrahjes Sociale dhe Strehimit dhe ka kërkuar që të bëjnë ndërhyrje në rregullimin e çatisë së banesës, pasi situata është emergjente, por nuk ka patur asnjë mbështetje dhe nuk është marrë asnjë masë për rregullimin e kushteve të jetesës të fëmijëve të saj.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, mbështetje sociale për fëmijët e saj dhe rregullimin e shtëpisë.

¹ E.Ç i përket komunitetit egjiptian të Bashkisë Korçë.

² Referuar Vërtetimit datë 06.11.2018 të Bshkisë Korçë, E.Ç trajtohet me ndihmë ekonomike në shumën 4500 lekë.

³ Referuar Çertifikatës Familjare nr.014212596, datë 28.05.2018, ankuesja është kryefamiljare nënë e tri fëmijëve.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 167, datë 23.10.2018 të E.Ç u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1472/1, datë 01.11.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Bashkinë Korçë për ankesën e bërë nga E.Ç dhe ka kërkuar kopje të dokumenteve me masat e marra nga Bashkia Korçë për mbështetjen e ankueses dhe të fëmijëve të saj.

Me shkresën nr. 7857/1, datë 14.11.2018, Bashkia Korçë në mes të tjerash informoi se: *“Familja e E.Ç, është një nga familjet e mbështetura prej më tepër se dy vjet nga ana e strukturës sociale të Bashkisë Korçë. Ankuesja prej dy vitesh ka kontaktuar me specialistët e Drejtorisë së Kujdesit Social, në një gjendje të dëshpëruar, vajzë nënë me dy fëmijë të mitur në një bashkëjetesë shumë problematike. Është ndihmuar menjëherë nga punonjës të Drejtorisë dhe është mbledhur urgjent tryeza multidisiplinare, për të ofruar paketën standarte të ndihmës. Menjëherë fëmijët janë*

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

dërguar në kopësht, duke u trajtuar në kopsht me drekë, të paguar me fonde nga buxheti i Bashkisë. Pagesa e kopshtit nga Bashkia është ndërprerë sepse E.Ç është larguar për në Turqi dhe propozimit të Bashkisë para rreth tri javësh për të rifilluar, nuk i është përgjigjur. I është akorduar ndihma ekonomike e cila vazhdon dhe sot. Meqënëse do të kishte kohën e lirë të nevojshme dhe ishte e re në moshë, nga Zyra Rajonale e Punësimit i është ofruar një vend pune. I është propozuar një subvencion nga fondet e Bashkisë, për të siguruar një mundësi strehimi me projektin e subvencionit të qirasë. Kjo mbështetje i është ofruar edhe nga një prej organizatave partnere. Specialistët e drejtorisë e kanë referuar familjarisht, tek një nga menecat sociale më cilësore dhe korrekte të partnerëve lokalë të Bashkisë, “Jezu Krishti për Ballkanin”, ku ka vazhduar prej dy vjetësh të trajtohet rregullisht. Me kërkesë të Bashkisë është ndihmuar me ushqime, veshmbathje dhe ilaçe nga organizatat: “Terres des Hommes”, “Mëshirë pa kufi për Shqipërinë” dhe “World Vision”. Meqënëse prindërit e djalit me të cilët bashkëjetonte ishin të gatshëm ta strehonin në shtëpinë e tyre, është përfshirë në projektin: “Përmirësimi i kushteve të banimit të komuniteteve në nevojë” për të rikonstruktuar shtëpinë dhe për ta bërë një ambient të përshtatshëm dhe për fëmijët nëse do të pranonin. Është vizituar dhe monitoruar rregullisht këto ditë dhe i është kërkuar urgjentisht të vizitojë fëmijët dhe në rast nevojë, Bashkia garantoj pagesën e medikamenteve nëse do ishte nevoja. Nga ai moment dhe në vazhdim, E.Ç nuk ka qenë me banim të përhershëm në Shqipëri. Ajo ka jetuar përkohësisht në Turqi, është kthyer dhe është larguar përsëri për në Francë (e pakonfirmuar zyrtarisht). Mundësitë për mbështetje janë dhe në vazhdim dhe Bashkia Korçë, nëse do jetë nevoja është e gatshme të ofrojë ndihmë, sidomos për fëmijët në kopësht dhe çerdhe dhe për E.Ç punësim, brenda mundësive dhe hapësirave ligjore”.

- Me shkresën nr. 1472/3, datë 26.11.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Bashkia Korçë, kopje të dokumentacionit, në të cilën provohet që E.Ç ka përfituar paketën standarte të ndihmës⁵, Bashkia Korçë ka paguar kopshtin me drekë për fëmijët, akordimin e ndihmës ekonomike, ofrimin e një vendi pune, subvencionin e qirasë nga fondet e bashkisë për sigurimin e një mundësie strehimi, pranimin në mencën sociale, garantimin e pagesës së medikamenteve, ofrimin e banesës falas si dhe dokumente të ndryshme që vërtetojnë ndihmat e përfituara nga E.Ç nga organizatat e ndryshme humanitare pas datës 17.05.2018.

Me shkresën nr. 7857/3, datë 03.12.2018, Bashkia Korçë ka informuar Komisionerin se për arsye të pushimeve për festat e Nëntorit dhe të axhendës së Drejtorisë së Kujdesit Social, kërkojnë shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumenteve të kërkuara për një datë të mëvonshme.

- Në këto kushte, mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 167, datë 23.10.2018, Komisioneri me shkresat nr. 1797, datë 28.12.2018 dhe nr. 30, datë 08.01.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 17.01.2019 duke kërkuar nga ana e Bashkisë Korçë, shpjegime dhe kopje të dokumenteve të kërkuar me shkresën 1472/3, datë 26.11.2018.

⁵ Referuar pikave 1, 2, 3, 5, 6, 7 të shkresës nr. 7857/1, datë 14.11.2018 të Bashkisë Korçë drejtuar Komisionerit.

Seanca dëgjimore e programuar për tu zhvilluar në datë 17.01.2019 nuk u zhvillua, pasi Bashkia Korçë dërgoi shpjegime me shkrim pranë Komisionerit, ndërsa subjekti ankues, referuar shërbimit postar⁶, ishte jashtë shtetit.

Me shkresën datë 09.01.2019, të dërguar pranë Komisionerit, Bashkia Korçë në mes të tjerash informoi se: *“Bashkia Korçë edhe pas vdekjes së ish bashkëjetuesit dhe babait të fëmijëve të E.Ç ka trajtuar rastin duke propozuar masa për mbështetje si më poshtë: -Mbështetje për të vazhduar trajtimin me ndihmë ekonomike⁷. –Vazhdimin me mbështetje për pagesën e kopshtit⁸ për 2 vajzat më të mëdha dhe futjen në çerdhe të vajzës së vogël, në mënyrë që ti krijohej mundësia për të filluar punë ose ndjekjen e një kursi të arsimit profesional. Në vijim i është propozuar E.Ç që nëse nuk kishte mundësi banimi, në vazhdim të asistojë nga Zyra e Strehimit për të përfituar rimbursim 100% të qirasë, sipas ligjit të Strehimit Social, të plotësuar me fonde të Bashkisë. Takim për plotësim informacioni, është kryer edhe në vizitën me prindërit e bashkëjetuesit të ndjerë. Problemi qëndronte në faktin se E.Ç, kërkoi të trajtohej me një banesë (edhe pse në pamundësi totale pagese) dhe nuk aplikoi për bonusin e strehimit. Gjithashtu në një moment ka përfituar edhe një banesë në bashkëpronësi me 33%, dhuratë nga një fondacion. Për këtë banesë, Bashkia ka aplikuar në bashkëpunim edhe me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Korçë, për t’ja nënshtruar rikonstruksionit sipas një projekti të Kryeministrisë për 61 Bashkitë. Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Korçë, ka kryer matjet në terren dhe ka përpiluar preventivin⁹, plan-vendosjen dhe skicat për të realizuar aplikimin në këtë projekt. Specialisti i zyrës së strehimit, inxhinieri i Bashkisë, përfaqësuesi i DRSHS dhe specialisti i projektit, kanë kontaktuar me E.Ç dhe nënën e saj, kanë kryer vizitë në banesën e dhuruar E.Ç, duke mbyllur dhe fazën e aplikimit. Detyrat e lëna nga tryeza multidisiplinare, janë zbatuar korrekt nga donatorët duke e mbështetur me paketa ushqimore, veshje, mbulesa dhe në rast nevojë edhe për blerje barnash. Përsa i përket ndihmave të ofruara nga donatorët, Bashkia nuk mund të sigurojë dokumentacion pasi donatorët kanë politikat e tyre për këto raste. Vizitat kanë vazhduar deri sa është konstatuar se E.Ç, që prej dy muajsh është larguar nga Shqipëria për në Francë, e verifikuar nga sistemi TIMS, së bashku me fëmijët, situatë e cila ka bërë të pamundur monitorimin e gjendjes social-ekonomike të familjes së saj”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të disfavourshëm nga Bashkia Korçë, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe civile.

Nenet 3, 9 dhe 24 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në mënyrë të përmbledhur parashikojnë se, vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet respektimit të të

⁶ Referuar shërbimit të Postës Shqiptare, subjekti ankues nuk ka marrë njoftim për shkresat: nr.1472/3, datë 26.11.2018, nr.1797, datë 28.12.2018 dhe nr.30, datë 08.01.2019 të dërguara nga zyra e Komisionerit, pasi ka qenë e larguar jashtë shtetit.

⁷ Referuar dokumenteve të dërguara nga Bashkia Korçë, E.Ç është trajtuar me ndihmë ekonomike për muajt: Maj, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor dhe Dhjetor 2018.

⁸ Referuar shkresës nr.496, datë 12.12.2018, fëmijët E.F dhe P.F janë shmangur nga tarifa mujore e Kopshtit nr.6.

⁹ Referuar: Preventiv me objekt: Punime çatie dhe punime të brendshme banesë kolektive.

drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera si dhe krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se strukturat e Bashkisë Korçë menjëherë pas ngjarjes së vdekjes së bashkëjetuesit të E.Ç kanë marrë masa të menjëhershme duke trajtuar çështjen me përparësi. Si rezultat i këtyre masave, punonjësit socialë të Bashkisë kanë organizuar vizitë në mjediset e banesës ku jetonte E.Ç, për të vlerësuar situatën¹⁰.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Korçë, vërtetohet se nga ana e Bashkisë Korçë, në muajin Maj e në vijim, janë marrë masat për trajtimin me ndihmë ekonomike të E.Ç. Po ashtu, referuar shkresës nr.496, datë 12.12.2018 të Ndërrmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit e Çerdhes të Bashkisë Korçë, vërtetohet se dy fëmijët e E.Ç, frekuentojnë Kopshtin nr.6 dhe janë shmangur nga tarifa mujore (arkëtimi mujor i ushqimit).

Në lidhje me sigurimin e strehimit për familjen E.Ç, nga ana e Bashkisë Korçë janë marrë masa proaktive në drejtim të strehimit, pasi nga ana e Bashkisë është bërë një studim për gjendjen e banesës si dhe është hartuar preventivi për riparimin e banesës.

Në lidhje me interesimin e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se ankuesi pas dorëzimit të ankesës nuk ka shfaqur asnjë interesim për të ndihmuar me informacion shtesë apo lidhur me kundërshtimin apo konfirmimin e informacionit të dhënë nga Bashkia Korçë për ndihmën që i ka ofruar ankueses.

Nga ana e inspektorit të çështjes dhe specialistes¹¹ së Komisionerit pranë Bashkisë Korçë është tentuar disa herë që të kontaktohej ankuesi nëpërmjet numrit të telefonit të depozituar pranë Komisionerit, por ankuesi nuk është përgjigjur dhe nuk ka qenë në shtëpi pasi ka qenë e larguar jashtë shtetit.

Mbështetur në informacionin e administruar, vërehet se nga ana e Bashkisë Korçë, për gjatë gjithë vitit 2018 janë marrë masa për trajtimin e familjes së E.Ç si më poshtë:

- Është trajtuar me ndihmë ekonomike.
- Është ndihmuar që dy fëmijët e saj të frekuentonin kopshtin pa pagesë.
- Është ndihmuar për ti siguruar kushte sa më të mira për strehim.
- Është referuar tek disa organizata humanitare për tu mbështetur me ndihma të ndryshme.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me

¹⁰ Referuar fotove të dërguara nga specialistja e Komisionerit, pranë Bashkisë Korçë, datë 20.12.2018.

¹¹ Referuar e-mail-it datë 22.11.2018 të specialistes së KMD-së.

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues, në raport me të drejtat e saj ligjore, nga ana e Bashkisë Korçë, pasi nga ana e kësaj të fundit janë marrë masa proaktive për ti ardhur në ndihmë familjes së E.Ç.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë, nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuseses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe civile.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases E.Ç nga ana e Bashkisë Korçë për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe civile.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA